

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Kontabiliteti Menaxherial

(zgjidhjet)

P2

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Nr.

Udhëzime/Instructions:

1. MOS E HAPNI DERISA T'IU LEJOHET PREJ
MBIKËQYRËSIT
Do Not Open Until Your Invigilator Allows You to Do So.

2. ËSHTË E DETYRUESHME PËRGJIGJA E GJITHA
PYETJEVE
All Questions Are Mandatory

3. KOHA E LEJUAR ËSHTË 3 ORË
Time Allowed is 3 Hours

4. EMRI JUAJ NUK DUHET TË PARAQITET NË ASNJË
FLETË TË KËTIJ PROVIMI.
Your name should appear nowhere in this test

Data: 30.01.2021

Problemi 1

Për secilin prej rasteve të pavarura në vijim të plotësohen zbrazëtitrat (zëvendësohen pikëpyetjet me vlerat e duhura):

(a) = 10 pikë

| Rasti | Të hyrat | Kostot variable | Kostot fikse | Totali i kostove | Fitimi operativ | Margjina e kontributit (%) |
|-------|----------|--------------------|-----------------|---------------------|--------------------|----------------------------------|
| 1 | 75,600 | ? | 13,750 | ? | ? | 40.00% |
| 2 | ? | 12,500 | ? | 18,900 | 7,250 | ? |
| 3 | 42,250 | ? | 11,445 | ? | 6,300 | ? |
| 4 | 18,400 | 12,300 | ? | 18,400 | ? | ? |

(b) = 10 pikë

| Rasti | Çmimi i shtijes për njësi | Kostot variable për njësi | Numri i njësive të shitura | Margjina e kontributit (Σ) | Kostot fikse (Σ) | Fitimi operativ |
|-------|---------------------------------|---------------------------------|----------------------------------|---|------------------------------|--------------------|
| 1 | ? | 10 | 150,000 | 300,000 | 220,000 | ? |
| 2 | 30 | 20 | 70,000 | ? | ? | (15,000) |
| 3 | 20 | 14 | ? | 120,000 | ? | 12,000 |
| 4 | 25 | ? | 180,000 | 900,000 | 800,000 | ? |

(Totali = 20 pikë)

Problemi 1 - Zgjidhja

(a)

| Rasti | Të hyrat | Kostot variable | Kostot fikse | Totali i kostove | Fitimi operativ | Margjina e kontributit (%) |
|-------|----------|--------------------|--------------|---------------------|--------------------|----------------------------------|
| 1 | 75,600 | 45,360 | 13,750 | 59,110 | 16,490 | 40.00% |
| 2 | 26,150 | 12,500 | 6,400 | 18,900 | 7,250 | 52.20% |
| 3 | 42,250 | 24,505 | 11,445 | 35,950 | 6,300 | 42.00% |
| 4 | 18,400 | 12,300 | 6,100 | 18,400 | 0 | 33.15% |

(b)

| Rasti | Çmimi i shtijes për njësi | Kostot variable për njësi | Numri i njësive të shitura | Margjina e kontributit (Σ) | Kostot fikse (Σ) | Fitimi operativ |
|-------|---------------------------------|---------------------------------|----------------------------------|---|------------------------------|--------------------|
| 1 | 12 | 10 | 150,000 | 300,000 | 220,000 | 80,000 |
| 2 | 30 | 20 | 70,000 | 700,000 | 715,000 | (15,000) |
| 3 | 20 | 14 | 20,000 | 120,000 | 108,000 | 12,000 |
| 4 | 25 | 20 | 180,000 | 900,000 | 800,000 | 100,000 |

Problemi 2

Kompania ABC prodhon dy produkte, produktin A dhe produktin B, të cilat të dyja përdorin të njëjtin lëndë të parë dhe punë me kualifikim të njëjtë. Norma e buxhetuar e pagave për punëtorët e drejtpërdrejtë që prodhojnë Produktin A dhe Produktin B është €12 për orë pune dhe java ka 40 orë pune. Herë pas here është e nevojshme të punohet jashtë orarit të për të cilën punë paguhet një premium prej 50%.

Gjithsej janë 120 punëtorë të punësuar në linjat e prodhimit dhe norma aktuale e produktivitetit/ efikasitetit që ata zakonisht e arrijnë është 90% për orët produktive në prodhimtarinë aktuale të produkteve. Drejtuesi i prodhimit më tej vlerëson se ndalesat jo-produktive janë buxhetuar në 20% të orëve produktive të punës.

Kompania përgatit buxhetet për çdo tremujor të ardhshëm (dymbëdhjetë javë nga 5 ditë në javë = 60 ditë) dhe parashikohet se shitjet dhe prodhimtaria do të ndodhin në mënyrë të barabartë gjatë gjithë tremujorit. Vlerësimet e mëposhtme janë përgatitur për periudhën e ardhshme:

| | <u>Produkti</u> <u>A</u> | <u>Produkti</u> <u>B</u> |
|--|-----------------------------|-----------------------------|
| Shitjet e buxhetuara (njësi) | 6,000 | 9,000 |
| Lëndët e para të buxhetuara të përdorura për njësi (kosto e buxhetuar e lëndëve të para €5 për kg) | 10 kg | 2 kg |
| Orët standarde të lejuara për njësi | 5 orë | 4 orë |

Në fillim të tremujorit të ardhshëm pritet që stoqet të jenë si vijon:

| | |
|--------------------------|-------------|
| Stoqet e Produktit A | 2,000 njësi |
| Stoqet e Produktit B | 2,500 njësi |
| Stoqet e lëndëve të para | 5,000 kg |

Menaxhmenti i Kompanisë ABC, ka një politikë për stoqet në fund të çdo tremujori. Ata kërkojnë sasi minimale të stoqeve të jetë në dispozicion për t'u siguruar nga rreziku i mbetjes pa stoqe për sa i përket produkteve të gatshme dhe lëndëve të para. Politika është si më poshtë:

| | |
|--------------------------|---|
| Stoqet e Produktit A | Stoqet përfundimtare të jenë ekuivalent i shitjeve të 10 ditëve |
| Stoqet e Produktit B | Stoqet përfundimtare të jenë ekuivalent i shitjeve të 20 ditëve |
| Stoqet e lëndëve të para | Stoqet përfundimtare të jenë ekuivalent i përdorimit të 10 ditëve |

Kërkohet:

a) Të përgatitet buxheti i (i) blerjes së lëndës së parë dhe (ii) buxheti i pagave të punëtorëve të prodhimit duke i paraqitur në sasi dhe vlerë për periudhën e ardhshme kontabël (tremujor) (16 pikë)

b) Përshkruani shkurtimisht katër informata shtesë, që ju nevojiten për të llogaritur pagesat javore në para të gatshme për lëndë të parë dhe paga për periudhën e buxhetuar. (4 pikë)

Zgjidhja e problemi 2

a) Buxheti i prodhimit për tremujorin e ardhshëm (Shënimi 3)

| | <u>Produkti</u> <u>A</u> | <u>Produkti</u> <u>B</u> | <u>Gjithsej</u> |
|--|-----------------------------|-----------------------------|-----------------|
| Shitjet e buxhetuara (njësi) | 6,000 | 9,000 | |
| <i>Plus:</i> Saldo përfundimtare e stokeve (Shënimi 1) | <u>1,000</u> | <u>3,000</u> | |
| | 7,000 | 12,000 | |
| <i>Minus:</i> Saldo fillestare e stokeve | <u>2,000</u> | <u>2,500</u> | |
| Kërkesat e prodhimit (njësi) | <u>5,000</u> | <u>9,500</u> | |
| | | | |
| Materialet e duhura për njësi | 10 kg | 2 kg | |
| Materialet e nevojshme (kg) | 50,000 | 19,000 | 69,000 |
| <i>Plus:</i> Saldo përfundimtare e stokeve të materialit (Shënimi 2) | | | <u>11,500</u> |
| | | | 80,500 |
| <i>Minus:</i> Saldo fillestare e stokeve të materialit | | | <u>5,000</u> |
| Materialet e përgjithshme që duhet të blihen (kg) | | | 75,500 |
| Kostot e buxhetuara të materialeve për kg. | | | <u>€ 5</u> |
| Vlera e materialeve të përgjithshme që duhet të blihen (€) | | | <u>€377,500</u> |

Shënimi 1: Janë 60 ditë pune në një periudhë kontabël. Sasitë ditore të shitjeve të buxhetuara janë 100 njësi të Produktit A (6,000/60) dhe 150 njësi të Produktit B (9,000/60). Prandaj, Stoket e buxhetuara përfundimtare të njësive të produkteve të gatshme janë si më poshtë:

$$\text{Produkti A} = 10 \text{ ditë} \times 100 \text{ njësi në ditë} = 1,000 \text{ njësi}$$

$$\text{Produkti B} = 20 \text{ ditë} \times 150 \text{ njësi në ditë} = 3,000 \text{ njësi}$$

Shënimi 2: Përdorimi 10 ditor i materialeve në sasi prej 1,150 kg në ditë (69,000/60)

Shënimi 3: Kërkesa e pyetjes është lidhur me Buxhetin e blerjes së materialeve. Kjo duhet të tregojë sasitë e lëndëve të para (në kg.) dhe vlerat e tyre (në €). Buxheti i prodhimit që tregon numrin e njësive të prodhimeve që duhet të prodhohen nuk është kërkuar në mënyrë strikte, por llogaritjet janë të nevojshme prej nga rrjedhin nevojat për materiale.

Buxheti i punës direkte (pagave) për tremujorin e ardhshëm

| | <u>Produkti A</u> | <u>Produkti B</u> | <u>Gjithsej</u> |
|--|---------------------------------|-------------------|--------------------|
| Prodhimtaria e buxhetuar (njësi) | 5,000 | 9,500 | |
| Orët standarde për njësi | <u>5 orë</u> | <u>4 orë</u> | |
| Prodhimtaria e buxhetuar (Orët standarde) | 25,000 | 38,000 | 63,000 |
| Orët e punuara për prodhimin e njësive të buxhetuara [63,000 x (100/90)] (Shënimi 4) | | | 70,000 |
| Plus: Ndalesat e buxhetuara jo-produktive (20% x 70,000) | | | <u>14,000</u> |
| Totali i orëve të kërkuara të prezencës së punëtorëve | | | <u>84,000</u> |
| Pagat e buxhetuara për t'u paguar: | | | |
| Koha normale | 120 punëtorë x 40 orë x 12 javë | 57,600 orë | |
| | 57,600 orë x €12 për orë | | € 691,200 |
| Puna jashtë orarit | 84,000 orë - 57,600 orë | 26,400 orë | |
| | 26,400 orë x €18 për orë | | <u>€ 475,200</u> |
| Totali i pagave të buxhetuara për t'u paguar | | | <u>€ 1,166,400</u> |

Shënimi 4: Punëtorët janë të paguar për prezencën në vendet e tyre të punës në total prej 84,000 orëve. Nga kjo 14,000 orë janë ndalesa jo-produktive [20% e orëve të produktive (70,000 x 20%)]. Orë produktive janë 70,000 orë, por efikasiteti gjatë kësaj kohe është 90%, prandaj njësitë aktuale të prodhuara janë ekuivalente me 63,000 orë punë për njësitë dalëse.

(b) Informata shtesë, që nevojiten për të llogaritur pagesat javore në para të gatshme:

- Kushtet e pagesës të ofruara nga furnizuesit
- Dita dhe orari i pagaesave të pagave
- Orari i pagaesave të tatimeve, sigurimeve, pensioneve etj.
- Analizat e pagave të bëra qoftë për punën jashtë orarit nëse për shembull nuk është konstante, etj.
- Angazhimi i punëtorëve të përkohëshëm për të mbuluar ata në pushime mjekësore, vjetore etj.
- Analizat e ndryshimeve në çmimet e materialeve si për shembull zbritjet për blerjet me shumicë etj.

Problemi 3

Kompania ABC prodhon produkte elektrike për përdorim në amvisëri. Ajo përdor modelin e SPE për të bërë vendimmarrje lidhur me menaxhimin e stokeve të lëndëve të para për produktet e saja. Ajo po merr në konsideratë vendimmarrjen lidhur me stoqet e Produktit X. Ky është një produkt shumë i kërkuar në treg. Të dhënat për vitin 2016 janë si më poshtë:

| | |
|--|--------------|
| Kërkesa e pritshme vjetore për produktin X | 22,500 copë |
| Kostoja e porositjes për porosi të blerjes | €162 |
| Kostoja vjetore e mbajtjes | €9 për njësi |
| Koha e përmbushjes së porosisë është | 12 ditë |

Kërkohet

- a. Duke supozuar se Kompania ABC punon 250 ditë në vit (8 pikë)
 - i. Të llogaritet SPE.
 - ii. Të llogaritet numri i porosive që do të bëhet brenda vitit.
 - iii. Të llogaritet totali i kostove të stokeve (kostos e porositjes dhe të mbajtjes)
 - iv. Të llogaritet niveli i porosisë së re.

Kohët e fundit furnitori kryesor i kompanisë ka instaluar softuerin kompjuterik që u mundëson klientëve të saj të bëjnë porositë e lëndës së parë on-line. Duke përdorur këtë teknologji kostoja e bërjes së porosisë së blerjes do të reduktohet në vetëm €50 për porosi.

Kërkohet

- b. Duke supozuar se të gjitha të dhënat tjera mbesin të njëjta
 - i. Të llogaritet SPE. 2 pikë
 - ii. Të llogaritet numri i porosive që do të bëhet brenda vitit. 2 pikë
 - iii. Të llogaritet totali i kostove të stokeve (kostos e porositjes dhe të mbajtjes) 2 pikë
- c. Diskutoni arsyet tradicionale për mbajtjen e stokeve. 4 pikë
- d. Shpjegoni se si stoqet e sigurisë përdoren për t'u përballur me pasigurinë e kërkesës. 2 pikë

Formula

$$SPE = \sqrt{\frac{2DP}{C}}, \text{ ku}$$

D = Kërkesa e pritshme vjetore

P = Kostoja e porositjes

C = Kostoja vjetore e mbajtjes për njësi

Zgjidhja e problemit 3

a.i. Llogaritja e SPE

$$D = 22,500 \text{ njësi}$$

$$P = €162$$

$$C = €9 \text{ për njësi}$$

$$\text{SPE} = \sqrt{\frac{2DP}{C}} = \sqrt{\frac{2 \times 22,500 \times €162}{€9}} = \sqrt{\frac{7,290,000}{€9}} = \sqrt{810,000} = \underline{900} \text{ njësi}$$

a.ii. Llogaritja e numrit të porosive brenda vitit

$$\begin{aligned} \text{Numri i porosive} &= \text{Kërkesa e pritshme vjetore} \div \text{Numri i njësive të SPE} \\ &= 22,500 \text{ njësi} \div 900 \text{ njësi} \\ &= \underline{25} \text{ porosi} \end{aligned}$$

a.iii. Llogaritja e kostove totale të stoqeve (kostove të porositjes dhe të mbajtjes)

$$\begin{aligned} \text{Kostot totale të stoqeve} &= (PD/Q) + (CQ/2) \\ &= [(\€162 \times 22,500) / 900] + [(\€9 \times 900) / 2] \\ &= (\€3,645,000 \div 900) + (\€8,100 \div 2) \\ &= \€4,050 + \€4,050 \\ &= \underline{\underline{\€8,100}} \end{aligned}$$

a.iv. Llogaritja e nivelit të porosisë së re

$$\begin{aligned} \text{Kërkesa ditore} &= \text{Kërkesa e pritshme vjetore} \div \text{numri i ditëve të punës} \\ &= 22,500 \text{ njësi} \div 250 \text{ ditë} \\ &= \underline{90} \text{ njësi për ditë punë} \end{aligned}$$

Koha e përmbushjes së porosisë **12** ditë

$$\begin{aligned} \text{Niveli i porosisë së re} &= \text{Numri i njësive për ditë pune} \times \text{Koha e përmbushjes së porosisë} \\ &= 90 \text{ njësi} \times 12 \text{ ditë} \\ &= \underline{\underline{1,080}} \text{ njësi} \end{aligned}$$

b.i. Llogaritja e SPE

$$D = 22,500 \text{ njësi}$$

$$P = €50$$

$$C = €9 \text{ për njësi}$$

$$\text{SPE} = \sqrt{\frac{2\text{DP}}{C}} = \sqrt{\frac{2 \times 22,500 \times \text{€}50}{\text{€}9}} = \sqrt{\frac{2,250,000}{\text{€}9}} = \sqrt{250,000} = \underline{500} \text{ njësi}$$

b.ii. Llogaritja e numrit të porosive brenda vitit

$$\begin{aligned} \text{Numri i porosive} &= \text{Kërkesa e pritshme vjetore} \div \text{Numri i njësive të SPE} \\ &= 22,500 \text{ njësi} \div 500 \text{ njësi} \\ &= \underline{45} \text{ porosi} \end{aligned}$$

b.iii. Llogaritja e kostove totale të stoqeve (kostove të porositjes dhe të mbajtjes)

$$\begin{aligned} \text{Kostot totale të stoqeve} &= (\text{PD}/\text{Q}) + (\text{CQ}/2) \\ &= [(\text{€}50 \times 22,500) / 500] + [(\text{€}9 \times 500) / 2] \\ &= (\text{€}1,125,000 \div 500) + (\text{€}4,500 \div 2) \\ &= \text{€}2,250 + \text{€}2,250 \\ &= \underline{\text{€}4,500} \end{aligned}$$

c. Arsyet tradicionale për mbajtjen e stoqeve:

- i. për të balancuar kostot e porosive ose përgatitjes dhe kostot e mbajtjes;
- ii. pasiguria e kërkesës;
- iii. defektet e makinerisë;
- iv. pjesët me defekt;
- v. pjesët që nuk janë të gatshme;
- vi. dërgesa e vonuar e pjesëve;
- vii. proceset e pasigurta të prodhimit;
- viii. për të përfituar të zbritjet (uljet) e çmimeve;
- ix. për t'u mbrojtur nga rritjet e ardhshme të çmimeve.

d. Stoqet e sigurisë janë stoqe shtesë që mbahen për të shërbyer si një sigurim ndaj luhatjeve të kërkesës. Stoqet e sigurisë llogariten duke shumëzuar kohën e përcaktuar për përmbushjen e porosisë me ndryshimin midis normës maksimale të përdorimit dhe normës mesatare të përdorimit.

Problemi 4

Bali Co. prodhon biskota kafeje të kualitetit të lartë që shiten në restorante dhe hotele. Dy muaj para fillimit të vitit 3 Bali Co e kishte përgatitur buxhetin për vitin 3.

Detalet e buxhetit të prezantuara më poshtë për vitin 3:

| | € |
|-------------------------------------|------------------|
| Shitjet | 6,000,000 |
| Zbritur: | |
| Materialet Direkte | 2,080,000 |
| | |
| Puna Direkte | 1,160,000 |
| Shpenzimet e përgjithshme variabile | 840,000 |
| Shpenzimet e përgjithshme fikse | <u>972,600</u> |
| | |
| Kostot totale | <u>5,052,600</u> |
| | |
| Fitimi | <u>947,400</u> |

Buxheti i mësipërm është përgatitur duke vlerësuar që shitjet do të jenë 800,000 paketa me biskota.

Megjithatë, me ndërrimin e kushteve ekonomike, shitjet aktuale për vitin 3 ishin 720,000 paketa me biskota. Çmimi i shitjes për njësi, kostot direkte për njësi dhe kostot variabile për njësi nuk ndryshon nga buxheti. Gjithashtu edhe shpenzimet e përgjithshme fikse janë të njëjta me buxhetin.

Menaxhmenti për momentin është duke konsideruar një numër alternativash për vitet e ardhshme.

Alternativa 1:

Duke zbritur çmimin e shitjes për 20%. Kjo do të ndikonte në rritjen e sasisë së shitjeve për 25% për vitin e ardhshëm në krahasim me shitjet në vitin 3.

Alternativa 2:

Zvogëlimi i të gjitha kostove variabile për 10% dhe zvogëlimi i kostove fikse për 10%. Nuk pritet të ketë ndonjë ndikim në nivelin e shitjeve në raport me vitin 3.

Alternativa 3:

Zvogëlimi i çmimit të shitjes për 10% dhe zvogëlimi i kostove fikse për 5%. Nga kjo pritet të rritet niveli i shitjeve për 25% në vitin e ardhshëm në krahasim me vitin 3.

Kërkohe:

(a) Kalkuloni fitimin e aktual për vitin 3 (3 pikë)

(b) Bazuar në aktivitetet aktuale të vitit 3 kalkuloni:

- (i) Pikën e rentabilitetit në njësi.**
- (ii) Margjina e sigurisë në përqindja.**
- (iii) Të hyrat e nevojshme për të arritur fitimin prej €1,440,000. (7 pikë)**

(c) Për secilën nga tre alternativat më lartë kalkuloni:

- (i) Fitimin.**
- (ii) Pikën e rentabilitetit në njësi.**

Rekomandoni cilën alternativ duhet ta pranoj kompania dhe jepni arsyet. (10 pikë)

(Total: 20 Pikë)

Zgjidhje e problemit 4

| (a) | € | Total Njësi | 720,000 |
|------------------------|---|-------------|----------------|
| | | € | |
| Shitjet | | 7.50 | |
| | | 5,400,000 | |
| Materialet | | 2.60 | |
| | | 1,872,000 | |
| Puna | | 1.45 | |
| | | 1,044,000 | |
| Shpp variabile | | | 1.05 |
| Total kostot variabile | | | 5.10 |
| Kontributi | | | 2.40 |
| | | | 1,728,000 |
| Zbritur: shpp fikse | | | 972,600 |
| Fitimi | | | 755,400 |

b)

$$(i) \text{ Pika e rentabilitetit} = \frac{€972,600}{€2.40} = \underline{405,250 \text{ njësi}}$$

$$(ii) \text{ Marxhina e sigurisë} = \frac{(720,000 - 405,250)}{720,000} = 43.7\%$$

$$(iii) \text{ Fitim i kërkuar} = 972,600 + 1,440,000 / 0.32 = 7,539,375 \text{ (Shitjet e nevojshme)}$$

c)

| | Alt. 1 | Alt. 2 | Alt. 3 | Aktual |
|---|------------------|------------------|----------------|----------------|
| Njësit | 900,000 | 720,000 | 900,000 | 720,000 |
| Shitjet | 5,400,000 | 5,400,000 | 6,075,000 | 5,400,000 |
| Kostot Variabile | 4,590,000 | 3,304,800 | 4,590,000 | 3,672,000 |
| Kontributi | 810,000 | 2,095,200 | 1,485,000 | 1,728,000 |
| Kostot fikse | 972,600 | 875,340 | 923,970 | 972,600 |
| Fitimi | -162,600 | 1,219,860 | 561,030 | 755,400 |
| Pika e rentabilitetit në njësi | 1,080,667 | 300,804 | 515,183 | 405,250 |
| Kalkulimi i pikës së rentabilitetit lartë | 972,600/0.9 | 875,340/2.91 | 923,970/1.65 | e dhënë më |

Rekomandim : Kompania duhet të konsideroj opsionin 2 sepse ka fitim më të lartë dhe pikë rentabilitetit më të ulët

Problemi 5

Vela Co. prodhon dhe shet një produkt të vetëm që quhet Produkti Y. Kompania aplikon sistemin e absorbimit të kostove për vlerësimin të produkteve të përfunduara (njësive dalëse) dhe stokeve në fund. Shpenzimet e përgjithshme të prodhimit (shpp) fikse absorbohen për njësi të prodhimit duke përdorur shkallën e paracaktuar të aplikimit bazuar në nivelin e pritur të aktivitetit prej 258,000 njësi për vite. Shpenzimet fikse të përgjithshme të prodhimit të buxhetuar për vite ishin €5,160,000.

Nuk kishte stoke fillestare në fillim të vitit financiar. Shitjet dhe prodhimet për tre muajt e parë të vitit ishin si më poshtë:

| | Muaji 1 | Muaji 2 | Muaji 3 |
|-------------------|----------------|----------------|----------------|
| Shitjet në njësi | 21,000 | 18,000 | 23,000 |
| Prodhimi në njësi | 21,000 | 22,500 | 20,000 |

Çmimi aktual i shitjes për njësi ishte €180. Kostot variabile të prodhimit për njësi ishin €80. Shpenzimet fikse të përgjithshme të prodhimit aktuale ishin si më poshtë:

Muaji 1: €410,000;

Muaji 2: €432,000

Muaji 3: €418,000.

Kostot fikse dhe administrative ishin €405,000 për secilin muaj.

Kërkohet:

(a) Përgatitini pasqyrën e fitimit operativ për muajin 1, muajin 2, muajin 3::

- (i) Sipas trajtimit të absorbimit (përvetësimit) të kostos.
- (ii) Sipas trajtimit marxhinal të kostos. (15 pikë)

(b) Shpjegoni dallimin në fitimin operativ për tre muajt sipas trajtimit të absorbimit (a)(i) dhe sipas trajtimit marxhinal të kostove (a)(ii). (5 pikë)

(Total: 20 Pikë)

Zgjidhja e problemi 5

(i) Fitimi operativ - Trajtimi Absorbimit

| | Muaji 1 | Muaji 2 | Muaji 3 |
|---------------------------------------|-----------|-----------|-----------|
| Shitjet | 3,780,000 | 3,240,000 | 4,140,000 |
| Kostot e shitjeve | | | |
| St. fillim (@ €100 për njësi) | 0 | 0 | 450,000 |
| Prodhimi (@ €100 për njësi) | 2,100,000 | 2,250,000 | 2,000,000 |
| Zbritur – St. fund (@ €100 për njësi) | 0 | -450,000 | -150,000 |
| | 2,100,000 | 1,800,000 | 2,300,000 |
| (Mbi)/nën absorbimi | -10,000 | -18,000 | 18,000 |
| | 2,090,000 | 1,782,000 | 2,318,000 |
| | | | |
| Fitimi Bruto | 1,690,000 | 1,458,000 | 1,822,000 |
| Kostot fikse dhe administrative | -405,000 | -405,000 | -405,000 |
| Fitimi Operativ | 1,285,000 | 1,053,000 | 1,417,000 |

] Fitimi operativ - Trajtimi Variabil

| | Muaji 1 | Muaji 2 | Muaji 3 |
|---|-----------|-----------|-----------|
| Shitjet | 3,780,000 | 3,240,000 | 4,140,000 |
| Kostot e shitjes variabilees | | | |
| St. në fillim (@ €80 për njësi) | | | |
| Prodhimi (@ €80 per unit) | 1,680,000 | 1,800,000 | 1,600,000 |
| Zbritur Stoku në fund (@ €80 për njësi) | 0 | -360,000 | -120,000 |
| | 1,680,000 | 1,440,000 | 1,840,000 |
| Kontributi | 2,100,000 | 1,800,000 | 2,300,000 |
| Kostot fikse të prodhimit | -410,000 | -432,000 | -418,000 |
| Kostot fikse dhe administrative | -405,000 | -405,000 | -405,000 |
| Fitimi Operativ | 1,285,000 | 963,000 | 1,477,000 |

6 marks

Puna

Stoku në fillim dhe fund

| | Muaji 1 | Muaji 2 | Muaji 3 |
|--------------------|---------|---------|---------|
| St. fillim | 0 | 0 | 4,500 |
| Njësit e prodhimit | 21,000 | 22,500 | 20,000 |
| Njësit e shitura | -21,000 | -18,000 | -23,000 |
| Stoku në fund | 0 | 4,500 | 1,500 |

Kalkulimi i shitjeve

| | Muaji 1 | Muaji 2 | Muaji 3 |
|---------------------------|-----------|-----------|-----------|
| Njësit e shitjes | 21,000 | 18,000 | 23,000 |
| çmimi I shitjes për njësi | 180 | 180 | 180 |
| Shitjet | 3,780,000 | 3,240,000 | 4,140,000 |

Kalkulimi I shkalles së paracaktuar të absorbimit =

€5,160,000/258,000 njësi = €20 për njësi

Kalkulimi mbi/nën aplikimit

| | Muaji 1 | Muaji 2 | Muaji 3 |
|---|----------------|----------------|----------------|
| Shpp aktuale | 410,000 | 432,000 | 418,000 |
| Shpp të aplikuara (njësit e prodhimit * €20 për njësi) | -420,000 | -450,000 | -400,000 |
| (Mbi)/Nën Aplikimi | -10,000 | -18,000 | 18,000 |

(b) Rikonsolidimi i fitimeve :

| | Muaji 1 | Muaji 2 | Muaji 3 |
|---------------------------------------|----------------|----------------|----------------|
| Fitimi operativ – trajtimi absorbimit | 1,285,000 | 1,053,000 | 1,417,000 |
| Fitimi operativ – trajtimi variabil | 1,285,000 | 963,000 | 1,477,000 |
| | 0 | 90,00 | -60,000 |